



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 143/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.03.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “R&T” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt, “Shërbim mirëmbajtje ndërtimore e objekteve në QSUT”, me nr. REF-96557-12-04-2018, me fond limit 68,143,412 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “R&T” sh.p.k
Adresa: Rr. “Luigj Gurakuqi”, Pall. 89, Shk. A., Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, nr.3, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 05.12.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër”, me objekt, “Shërbim mirëmbajtje ndërtimore e objekteve në QSUT”, me nr. REF-96557-12-04-2018, me fond limit 68,143,412 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2 Në datën 07.01.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 23.01.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “R&T” shpk	41,135,098.00 lekë, Skualifikuar;
2. ”Viante Konstruksion” & ”Euro Alb” shpk	45,690,482.00 lekë, Skualifikuar;
3. “Dajti Park 2007” & ”Altec” shpk	47,558,440.00 lekë, Skualifikuar;
4. “Ed Konstruksion” shpk	52,472,600.00 lekë, Skualifikuar;
5. “Shpresa” shpk	52,880,560.50 lekë, Skualifikuar;
6. “Modeste” & ”Arkonstudio” shpk	53,925,742.00 lekë, Skualifikuar;

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “R&T” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 3.3 “Kapaciteti teknik” të DT, sepse nuk ka paraqitur Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës) për makinat e transportit të llojit kamionçinave të paraqitura si dhe për autovinça”

II.5.Në datën 29.01.2019 operatori ekonomik “R&T” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 264/1 Prot. datë 05.02.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “R&T” sh.p.k, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.7.Në datën 14.02.2019 operatori ekonomik “R&T” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Per te kundërshtuar vlerësimin e bere nga KVO, OE paraqiti fillimisht para AK në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj in nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ankim kunder ketij vlerësimi me argumentet si me poshte: Mjeti Autovinc nuk klasifikohet ne mjet transporti mallrash por ka percaktimin e vet referuar Kodit Rrugor (2018) , Neni 54 Automjetet, pika g): g) Automjet që përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave. Ne mbështetje të percaktimeve te mesiperme OE ka paraqitur ne SPP per mjetin Autovinc dokumentacionin e meposhtem: 1. Leje qarkullimi për autovinçin me targë DR8426C dhe autovinçin me targë AA206NJ; 2. çertifikaten e kontrollit teknik për autovinçin me targë DR8426C dhe autovinçin me targë AA206NJ 3. Siguracionin e mjetit për autovinçin me targë DR8426C dhe autovinçin me targë AA206NJ, ku referuar Lejes së Qarkullimit, Pika 1, Lloji i automjetit: APV; të autovinçave (dokumentacion i kërkuar nga AK për këtë procedurë prokurimi) mjeti autovinç nuk klasifikohet mjet transporti mallrash (ATP Automjet per transport te përzier) por & Automjet në Përdorim të Vecantë, për pasojë autovinçat nuk pajisen me leje transporti mallrash. Sa më sipër KVO në shkelle të LPP, ka klasifikuar autonviçat në kategorinë e gabuar dhe ka bërë vlerësim në kundërshtim të kërkesave në DST, LPP dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (i ndryshuar), Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 3.3.Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Lidhur me dorëzimin e lejes së qarkullimit për mjetet Kamionçinë 1-3 ton sqarojmë se OE R&T shpk, ka dorëzuar për këtë procedurë prokurimi dokumentacionin e kërkuar nga AK, për automjetet me targë: TR0847R, referuar Lejes së qarkullimit, me masë 2760 kg (nën 3 ton); TR0846R referuar Lejes së qarkullimit, me masë 2760 kg (nën 3 ton). Po ti referohemi Udhëzimit nr.5781 dt.23.12.2003 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së licencave, lejeve, certifikatave dhe autorizimeve për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, kreu II, pika 3.3, a) dhe 4.3 si dhe Urdhresës me nr. 14444 prot.dt.06.10.2015 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë

mbi “Organizimin e planit të levizjes të automjeteve në qytetin e Tiranës”, Pika 2, ku specifikohet se: Ndaloheq qarkullimi I të gjitha mjeteve të transportit të mallrave prej orës 07.00-09.00 si dhe i mjeteve me ngarkesë të përgjithshme mbi 3.5 t, me kufizim prej orës 09:00-20:00, në Unazën e Mesme të qytetit, në brëndësi të saj, si dhe në akset kryesore hyrëse në të duke përfshirë dhe rrugët “Sulejman Delvina “Abdyl Frashëri”, “Ismail Qemali “Rrugës së Elbasanit” dhe bulevardit “Bajram Curri”. Subjektet tregtare do të kryej veprimtarinë e tyre furnizuese nga ora 20:00-7:00 dhe për mjetet deri 3.5 t edhe nga 09.00 deri në 20.00, Sipas sinjalistikës së vendosur. KVO në shkelje të LPP dhe në kundërshtim me Urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ka kërkuar dokumentacionin për këto mjete të cilat janë nën 3 ton e për pasojë janë të përjashtuar nga Urdhëresa. Pretendimi i KVO nuk është në përputhje me kërkesat e DST (ku kërkoheq kamionçinë 1-3 ton) dhe në shkelje të Vendimin 914 datë 29.12.2014 (i ndryshuar), Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 3: 3.Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Sa më sipër OE kërkoj nga AK ndryshimin e vlerësimit të KVO dhe kualifikimin e OE R&T sh.p.k në respektim të LPP dhe dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha kërkesat e listuara në pikën 1 Referuar DST seksioni 3.3, pika 8: që citon AK, janë të plotësuara dhe të tejkaluara nga ofertuesi R&T shpk. Gjithashtu theksojmë se Autoriteti Kontraktor nuk ka sjellë asnjë reference në ligj ku të mbështes pretendimin e tij dhe për më tepër edhe konkluzioni final i marr po nga Autoriteti Kontraktor bie ndesh me vete kërkesat e DST.[...]”

II.8.Në datën 25.02.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.369/1prot., datë 21.02.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.



pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “R&T” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: “[...]1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 3.3 “Kapaciteti teknik” të DT, sepse nuk ka paraqitur Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës) për makinat e transportit të llojit kamionçinave të paraqitura si dhe për autovinça”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën nr. 8, pika 3.3.8, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“8.Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës

-Kamiona veteshkarkues (kapaciteti total mbajtes mbi 10 Ton)	cope 1 (nje),
-Auto Vinc	cope 2 (dy)
-Motogjenerator	cope 1 (nje)

-Kamioncine 1-3 ton	cope 2(dy)
-Betoniere kantieri	cope 2 (dy)
-Pompe suvatimi	cope 2(dy)
-Pompe uji	cope 1 (nje)
-Depozite uji (5000 litra)	cope 1 (nje)
-Skela	1000 m2

Pronesia e mjeteve te mesiperme te vertetohet si me poshte :

Ofertuesi duhet te paraqesë per makinerite te cilat jane ne pronesi, lejet e qarkullimit te tyre (te cilat duhet te jene ne emer te shoqerise). Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk pajisen me leje qarkullimi ofertuesi duhet te paraqesë kontrate noteriale te blerjes ose fatura tatimore te blerjes ose dokument zhdoganimi te pajisjes.

Pranohet marrja me qira ose huaperdorje e mjeteve/pajisjeve te mesiperme, me kusht qe kontratat e qiramarrjes ose te huaperdorjes te jene te lidhura para noterit, me afat vlefshmerie të paktën 12 muaj nga koha e zhvillimit të procedurës.

Shënim :

Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me:

-Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës)

-Leje qarkullimi,

-certifikaten e kontrollit teknik,

-leje drejtimi per drejtuesin e mjetit te transportit (patenta për të paktën 1 drejtues mjeti)

-siguracionin e mjetit,

leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit.”

III.1.2.Nga verifikimi i kryer në SPE, rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin si vijon :

1. Kontratë qiraje nr.12rep., nr.06/1kol., datë 05.01.2019, lidhur ndërmjet shoqërisë “R&T” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit dhe personit fizik “A.H.” sh.p.k. në cilësinë e qiradhënësit, me objekt dhënien me qira të mjetit Autovinc me targë AA206Nj, shoqëruar me leje qarkullimi, policë sigurimi mjeti, certifikatë të kontrollit teknik dhe certifikatë pronësie.
2. Kontratë qiraje nr.13rep., nr.07/1kol., datë 05.01.2019, lidhur ndërmjet shoqërisë “R&T” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit dhe personit fizik “A.E.” sh.p.k. në cilësinë e qiradhënësit, me objekt dhënien me qira të mjetit Autovinc me targë DR8426C, shoqëruar me leje qarkullimi, policë sigurimi mjeti, certifikatë të kontrollit teknik dhe certifikatë pronësie.
3. Leje qarkullimi, policë sigurimi mjeti, certifikatë të kontrollit teknik dhe certifikatë pronësie, të mjetit kamioncinë me targë TR0847R, në pronësi të shoqërisë “R&T” sh.p.k.
4. Leje qarkullimi, policë sigurimi mjeti, certifikatë të kontrollit teknik dhe certifikatë pronësie, të mjetit kamioncinë me targë TR0846R, në pronësi të shoqërisë “R&T” sh.p.k.
5. Leje qarkullimi, policë sigurimi mjeti, certifikatë të kontrollit teknik dhe certifikatë pronësie, të mjetit kamioncinë me targë TR5492U, në pronësi të shoqërisë “R&T” sh.p.k.
6. Leje qarkullimi, policë sigurimi mjeti, certifikatë të kontrollit teknik dhe certifikatë pronësie, të mjetit kamioncinë me targë TR0907S, në pronësi të shoqërisë “R&T” sh.p.k.

III.1.3.Në nenin 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të

prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.4. Në nenet 41 - 47 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar parashikohet se: “Neni 41 - Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Neni - 42 Kur transporti i mallrave për të tretë dhe me qira kryhet me pagesë, ky çmim të mbështetet në dispozitat e ligjit “Për çmimet dhe tarifat”. Neni 43 - Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm për ndërmarrjet që kryejnë transport mallrash për të tretë dhe me qira, brenda vendit, me anë të mjeteve motorike ose të kombinimeve të mjeteve. Kapaciteti maksimal i lejuar i transportimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Neni 44 - Llojet e transportit të mallrave me qira dhe për të tretë, të cilat mund të kryhen pa licencë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë. Neni 45 - Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë. Neni 46 - Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg. Neni 47 - Llojet e mallrave për transport brenda vendit për nevojat e veta që nuk kanë nevojë për certifikatë, përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrisë.”

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, përkatësisht shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”, me anë të së cilës operatori ekonomik ankimues “R&T” sh.p.k., deklaron se zotëron mjetet dhe pajisjet teknike për të realizuar kontratën objekt prokurimi, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për kamioncinat, referuar dokumentit leje e qarkullimit të mjetit, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave edhe kapaciteti mbajtës i tij, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg), evidentohet si më poshtë:

Public Health Sector

- Për mjetin me targë TR0847R, kapaciteti mbajtës = 990 kg.
- Për mjetin me targë TR0846R, kapaciteti mbajtës = 990 kg.
- Për mjetin me targë TR5492U, kapaciteti mbajtës = 970 kg.
- Për mjetin me targë TR0907S, kapaciteti mbajtës = 700 kg.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me disponueshmërinë e mjeteve Kamioncina, konstaton se, asnjë prej këtyre mjeteve nuk e tejkalon kapacitetin transportues prej 1500 kg, në mënyrë që të lind detyrimi për pajisjen me certifikatë transporti sipas parashikimeve të nenit 46 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar. Ndërsa lidhur me mjetet autovinc të paraqitura nga ankimuesi, nga shqyrtimi i dokumentacionit (leje qarkullimi, certifikatë pronësie etj), rezulton se këto dy mjete përfshihen në kategorinë APV (Automjet për Përdorim të Vecantë), të cilët nuk shërbejnë për transport mallrash në mënyrë që lind detyrimi për pajisje me certifikatë transporti sipas parashikimeve të nenit 43 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, në të cilin sanksionohet në mënyrë eksplicite se “Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm për ndërmarrjet që kryejnë transport mallrash për të tretë dhe me qira, brenda vendit...” Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, operatorët ekonomik janë të detyruar të paraqesin certifikatën e

transportit vetëm për automjetin kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, përsa kohë për mjetet e tjera nuk lëshohen certifikata transporti nga autoritetet përkatëse për transportin e mallrave, atëherë këto mjete mund të qarkullojnë lirisht për të kryer me sukses objektin e kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "R&T" sh.p.k. qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "R&T" sh.p.k, për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur – Marrëveshje kuadër", me objekt, "Shërbim mirëmbajtje ndërtimore e objekteve në QSUT", me nr. REF-96557-12-04-2018, me fond limit 68,143,412 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik "R&T" sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "R&T" sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 234 protokolli Datë 14.02.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha